

VENDIM
Nr. 46, datë 31.3.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “C.G.C”
SH.P.K. NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 105, 107; nenit 22 pika 2 germa “ç”; nenit 83 pika 1 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 4, pika 1, germa “ç”; neni 8 dhe 9 pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pika 1 nenin 11 të “Rregullave dhe Procedurave për Licencimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjeshtëm ose të Plotë, Heqjen ose Rinovimin e Licencave në sektorin e Gazit Natyror” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.9, datë 11.2.2011, nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.6.2016 Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C.G.C” SH.P.K, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të shoqërisë “C.G.C” sh.p.k.

Konstatoi se:

- Formatit dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, germa “d”/i, d/ii, është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Germat: d/iv, d/v, d/vi(identitetin e personave që kanë interes pronësor më të madh dhe të barabartë se 5%, dokumentet që tregojnë titujt e pronësisë, lejet dhe autorizimet mjedisore), janë të paplotësuar;
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/v, e/vi(vërtetim nga drejtoria e tatimeve, bilanci financiar, pagesa e aplikimit në ERE, plani i biznesit), janë plotësuar;
- Germa: e/vii(garanci e preformancës) nuk ka informacion.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa e/i, e/ii, sasia e gazit në Nm3 dhe garancia e cilësisë gazit), është e pa plotësuar
- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9 pika 2 germa e/iii garancia financiare), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mangësitë e konstatuara referuar: neni 9, pika 1, germa d/iv, d/v, d/vi; neni 9, pika 1 germa e/vii; neni 9, pika 2, germa e/i, e/ii, do të njoftohet subjekti në bazë të nenit 10 pika 1 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjeshtëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”,

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “C.G.C” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti